Albanian

Rruga Webster, Dandenong, tetor 2026

Mbjelljet dhe sistemimi i peizazhit

LEVEL CROSSING REMOVAL PROJECT

Kemi mbyllur përgjithmonë rrugën Webster te kalimi në nivel, ndërsa nënkalimin i ri rrugor në Dandenong që lidh rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond është hapur të martën më 22 shtator.

Nënkalimi i ri rrugor zvogëlon mbingarkesën dhe ofron një rrjet rrugor më të besueshëm për Dandenong, duke u mundësuar shoferëve të udhëtojnë drejtpërdrejt nga rrugët Hammond dhe Cheltenham në perëndim deri në një kryqëzim të ri të sinjalizuar në rrugën Princes Highway-Lonsdale në lindje.

Vitin e kaluar kemi hapur një shteg të ri për ecje dhe çiklizëm përgjatë rrugës Webster, e cila lidhet me shtegun ekzistues Dandenong Creek, duke siguruar një lidhje më të sigurt për këmbësorët dhe çiklistët nën linjën hekurudhore.

Një mural i ri, Ways of Wandering (Mënyrat e endjes), është pikturuar me dorë përgjatë shtegut të ecjes dhe çiklizmit dhe nën urën hekurudhore.

Përshtypjet e komunitetit kanë ndihmuar në përcaktimin e projektimit të peizazhit, pasi shumë njerëz na thanë se dëshironin të shihnin bimësi vendase dhe autoktone.

Këto lloje bimësh janë përzgjedhur për të mbështetur lidhshmërinë e habitateve dhe për të rritur diversitetin me lloje të tjera vendase.

Përdorimi i bimëve vendase vë në pah biodiversitetin lokal dhe përfiton nga fakti që bimët e reja janë më të përshtatshme për të lulëzuar në kushtet klimatike dhe të tokës të zonës përreth.

Kemi mbjellë më shumë se 80 pemë

Vitin e kaluar kemi mbjellë 15 pemë të reja në Rezervatin Woodcock të Dandenong-ut, duke rritur mbulesën e kurorave të pemëve dhe biodiversitetin.

Kemi mbjellë më shumë se 80 pemë në të gjithë zonën e projektit. Pranë hyrjeve të nënkalimit të ri janë mbjellë lloje vendase, si Wilga, Lemon scented gum, River red gum dhe Red flowering iron bark.

Pemët Smooth-barked Apple Gum (Angophora costata), të mbjella përgjatë Dandenong Creek, janë përzgjedhur për t'iu përshtatur peizazhit dhe gjeologjisë ekzistuese të zonës.

Pemët vendase ishin deri në 1.5 metra të larta kur janë mbjelle dhe do të rriten deri në 25 metra.



Pemë Smooth-barked Apple Gum e mbjellë në Woodcock Reserve vitin e kaluar



Sistemimi i peizazhit pranë nënkalimit të ri rrugor

Regjistrohuni për përditësime
levelcrossings.vic.gov.au

VICTORIA'S BIG BUILD

Shkurre, bimë për mbulimin e tokës dhe bimë me lule

Kemi mbjellë mbi 20 lloje shkurre dhe bimë me lule. Do të shihni lloje të tilla si Creeping boobialla, Yellow buttons, Kangaroo paw, Knobby club rush dhe Correa alba.

Bimët për mbulimin e tokës janë bimë me rritje të ulët, shkurre dhe barishte që përhapen horizontalisht, duke krijuar një mbulesë të ngjashme me një qilim. Këto lloje bimësh ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës dhe përhapjes së barërave të këqija, si dhe në rritjen e biodiversitetit lokal.

Kemi bashkëpunuar me peizazhistë të kualifikuar për të zbatuar një program të detajuar të monitorimit dhe mirëmbajtjes së peizazhit. Vlerësimet e rregullta të mbjelljeve të reja do të vazhdojnë për të përcaktuar gjendjen e tyre shëndetësore dhe aftësinë për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar.

Do ta monitorojmë zonën për dy vjet për të siguruar mirëmbajtjen e duhur të të gjithë bimësisë.

Pas kësaj, kujdesi për hapësirën e gjelbër do t 'i transferohet autoritetit përkatës, siç është Këshilli i qytetit Dandenong.

Në Dandenong kemi mbjellë:

- Më shumë se 80 pemë vendase
- 30,000 shkurre dhe bimë me lule
- Më shumë se 30 lloje të ndryshme pemësh dhe bimësh.



Correa alba



River red gum




Wilga



Red flowering iron bark



Kangaroo paw



Creeping boobillia



Yellow buttons



Knobby club rush

Afati kohor i projektit

2018

- Projekti u njoftua

2022 deri në fund të vitit 2023

- Hetimet në terren, sondazhet e trafikut dhe punimet e planifikimit

Nëntor 2023

- Dizajnet konceptuale janë lëshuar
- Konsultimi me komunitetin
- Hetimet në terren vazhdojnë

Fundi i vitit 2024

- Dizajnet përfundimtare janë lëshuar
- Punimet e para

2025

- Fillon ndërtimi
- Hapet shtegu i ecjes dhe çiklizmit nën linjën hekurudhore
- Barrierat hiqen përgjithmonë
- Rruga Webster mbyllet te kalimi në nivel

2026

- Ndërtimi
- Hapet nënkalimi rrugor i ri
- Sistemimi i hapësirave të jashtme

2027

- Projekti përfundon

** Afatet kohore mund të ndryshojnë.*

levelcrossings.vic.gov.au

levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au

Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)

Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni **relayservice.gov.au**

VICTORIA State Government

NWP13153